



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE Durrës



NOTER GERTJAN KËRÇUKU
ADRESA Rruga "Aleksander
Goga", Durrës
TEL: 0694080105

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 587

Nr. koleksioni: 226

Durrës më 11/06/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"

*Akti notarial përbëhet nga 3 fletë



A2020014400021266121



A2020014400021266121



KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot, me 11 / 06 / 2020, përpara meje Gertjan Kërçaku, Noter i Dhomës së Noterisë Durrës, lidhet kjo Kontrate nga dhe ndërmjet:

SHITESI: “**T P L A N I**” shpk, nje shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NIPT K61521026Q dhe seli ne Lagjja Partizani, Pallati 22, Tropoje, Bajram Curr, e përfaqësuar ligjërisht nga Administratori i vetëm, njëkohësisht ortak i vetem i saj, **Z. Flamur Buçpapaj**, i biri i Mehmetit, i ditëlindjes 10.3.1968, banues ne Tirane, i identifikuar me nr. personal G80310105E, madhor e me zotësi te plote juridike për te vepruar, pa kufizime te kompetencave te administrimit;
(ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si “Shitësi”)

dhe

BLERESI: “**ANUAR**” shpk, nje shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NIPT L72003029I dhe seli ne Rruga Donika Kastrioti, Pallati 14, Ap 14E, Kati i 5, Njesia Bashkiake nr. 5, Tirane, e përfaqësuar ligjërisht nga Administratori i vetëm, **Z. Aurel Byberi**, i ditëlindjes 28.1.1985, lindur ne Bajram Curri, Tropoje e banues ne Tirane, i identifikuar me me nr. personal I50128082V, madhor e me zotësi te plote juridike për te vepruar, pa kufizime te kompetencave te administrimit;
(ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si “Blerësi”)

Palët e mësipërme ne vijim dhe për efekt te kësaj Kontrate, do te referohen individualisht si “Pale/a” dhe se bashku si “Pale/et”.

MEQENESE:

- Shitësi është ortak zotërues i 41% (dyzet e një përqind) të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “TPLANI HC” Sh.P.K. (ne vijim “*Shoqëria*”), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS L09702601M dhe seli ne Godine 2 kateshe ne Fshatin Valbone, Margegaj, Kukës, kapitali themeltar i regjistruar i te cilës është ne shumen ALL 100 (njëqind Lekë), sikurse rezulton nga Ekstrakti i Regjistrit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 21% (njëzet e nje përqind) të kapitalit te Shoqërisë (ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si “*Kuota*”) dhe Bleresi dëshiron te blejë Kuoten.
- Kalimi i Kuotes sipas kesaj Kontrate eshte miratuar me vendimin bashkëlidhur te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise si dhe nga Asambleja e Shitesit dhe Bleresit.
- Nga verifikimi i Regjistrit te Barreve Siguruese, Kuota rezulton te jete e lire dhe e pa barrësuar.



PER SA ME SIPER, Palët ranë dakord për të lidhur këtë Kontrate Shitje Kuote.

NENI 1 OBJEKTI

- 1.1. Objekt i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë së Kuotës sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontrate nga Shitësi të Blerësi dhe fitimi i pronësisë nga Blerësi mbi Kuotën që përfaqëson 21% (njëzet e një përqind) të kapitalit të Shoqërisë "TPLANI HC" Sh.P.K. me NIPT L09702601M dhe seli në Godinë 2 kateshe në Fshatin Valbone, Margegaj, Kukës.

NENI 2 ÇMIMI DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1. Çmimi i shitjes së Kuotës është caktuar në marrëveshjen e paleve në vlerën prej EUR 10.000 (dhjetë mijë Euro) dhe do t'i paguhet Shitesit nga Blerësi nëpërmjet transferimit të shumës në llogarinë bankare të Shitesit brenda 10 (dhjete) diteve pune pas lidhjes së kësaj Kontrate.
- 2.2. Çmimi i shitjes gjendet i drejtë dhe i arsyeshëm dhe Palët garantojnë se me nënshkrimin e kësaj Kontrate nuk do të kenë asnjë pretendim të çfarëdolloji në lidhje me çmimin e shitjes dhe shprehimisht heqin dorë përfundimisht nga çdo pretendim dhe/ose rezerve dhe/ose padi në lidhje me shumën e çmimit të shitjes të përcaktuar në këtë Kontrate.

NENI 3 KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTEN

- 3.1. Pronësia mbi Kuotën që përfaqëson 21% (njëzet e një përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë do të kalojë nga Shitësi të Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate.
- 3.2. Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë, me lidhjen e kësaj Kontrate, do të jetë si vijon:
- TPLANI shpk zoterues i 20 pjesëve të kapitalit me vlerë prej 20 leke dhe që përfaqësojnë 20% (njëzet përqind) të kapitalit të shoqërisë TPLANI HC shpk; dhe
 - ANUAR shpk zoterues i 80 pjesëve të kapitalit me vlerë prej 80 leke dhe që përfaqësojnë 80 % (të tetëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë TPLANI HC shpk.

NENI 4 DEKLARATA DHE GARANCI

4.1. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:

- a. Shitësi është zotëruesi i vetëm i pjesëve të kapitalit që transferohen nëpërmjet kësaj Kontrate dhe ai gëzon gjithë të drejtat e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh prej tyre dhe ka tagra të plota për të kaluar pjesët e kapitalit të zotëruara prej tij.
- b. Kuota është nënshkruar dhe paguar plotësisht.
- c. Kuota e zotëruar nga Shitësi është lirish e transferueshme dhe asnjë miratim tjetër nuk nevojitet për realizimin e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate. Shitësi i jep Blerësit garancitë më të plota të eviksionit dhe garanton se në rast se ndonjë palë e tretë do të ngrejë pretendime në lidhje me të drejtat mbi Kuotën, Shitësi do të garantojë që pronësia e Blerësit mbi Kuotën të mos cenohet në asnjë mënyrë a masë.
- d. Kuota është e lirë nga çdo lloj pengu, detyrimi, takse, pretendimi, të drejtë parablerjeje, apo barre tjetër dhe asnjë person i tretë nuk ka asnjë të drejtë reale apo garancie mbi Kuotën. Shitësi ka të drejtë të shesë dhe t'ia transferojë Kuotën Blerësit sipas kësaj Kontrate. Blerësi fiton të drejtat e plota e të pakufizuara të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate.
- e. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Shitësi është palë.
- f. Me lidhjen e kësaj Kontrate, Shitësi garanton Blerësin se do t'i sigurojë atij kontrollin efektiv të



Shoqërisë në përputhje me te drejtat që rezultojnë nga zotërimi i Kuotës.

- g. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

4.2. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

- Blerësi do të paguajë çmimin e shitjes sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
- Blerësi ka tagra të plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.
- Nënshkrimi apo zbatimimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Blerësi është palë.
- Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

4.3. Palet deklarojnë se shoqëria TPLANI HC Shpk zoteron një HEC me fuqi të instaluar 4.2 Mw, nga të cilat TPLANI do të marrë 20% (njëzetë për qind) të fitimit të ditëve që Hec-i punon. Palet deklarojnë dhe garantojnë njëra tjetres se HEC-i do të përfundojë punimet në Dhjetor 2020.

4.4. Palët konfirmojnë se detyrimi i Blerësit për pagimin e çmimit të shitjes është përmbushur përpara lidhjes së Kontratës.

Neni 5 DISPOZITA TË FUNDIT

5.1. Kjo Kontrate hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

5.2. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çënohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

5.3. Kjo Kontrate përmban marrëveshjen e plote ndërmjet palëve në lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

5.4. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

5.5. Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontratës i bashkëlidhen kopje të ekstrakteve të regjistrit tregtar të paleve dhe Shoqërisë, dokumentet e identifikimit të përfaqësuesve, Ekstrakt nga Regjistri i Barrëve Siguruese dhe Vendimet e asambleve të ortakeve të shoqërisë shitëse dhe blerëse si dhe të shoqërisë kuotat e të cilës kalohen nëpërmjet kësaj kontrate.

Unë Noteri e hartova këtë Kontratë sipas kërkesës së Palëve në gjuhën Shqipe dhe në katër origjinalë e pasi ua lexova me zë të lartë e të qartë, u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të shprehur përpara meje, nënshkruhet prej tyre rregullisht në praninë time dhe unë e vërtetoj sipas ligjit dhe për të gjithë pasojat e tij.

SHITËSI

TPLANI shpk

Përfaqësuar nga Administratori

Flamur Buçpapaj

Flamur Buçpapaj



NOTERI

GERTJAN KËRÇUKU

BLERËSI

ANUAR shpk

Përfaqësuar nga Administratori

Aurel Byberi

Aurel Byberi

ANUAR HP

L720030291